



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 29.01.2016, në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletić, Sasha Milosavljević, Slavko Simić, Çerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi dhe Senad Karaahmetović, përfaqësuese e RTK- sërbisht-Marija Stanojević, përfaqësuese e BIRN – Amire Qamili, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Stafi mbështetës i Komisionit, Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Zhivković, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Hartimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2016;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Hartimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2016;

Kryesuesi, tha se në bazë të Rregullorës së Kuvendit dhe programit Legjislativë të Qeverisë ngarkohet Komisioni të hartoj planin e punës, për vitin 2016. Në kuadër të hartimit të Planit të punës, njëra nga kompetencat kryesore të Komisionit është mbikëqyrja e zbatimit të Ligjeve. Këtë vit, si aktivitet i ri është procesi i mbikëqyrjes buxhetore të resorit të linjes përkatëse.

Në bazë të programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2016, do të shqyrtohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Për realizimin e vizitës regjionale në Republikën e Kroacisë, do të ofrohet mbështetje financiare nga misioni i OSBE-së, për 8 anëtar të komisionit.

Sa i përket aktiviteteve të Komisionit, me prioritet nga viti i kaluar do të jetë vazhdimi i procesit të monitorimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 11, Ligji për Vetëqverisje lokale. Gjegjësisht, për monitorimin e ligjeve tjera me prioritet, pëcaktohet në puntorin e punës së Komisionit.

Kryesuesja, hapi depat, me qëllim që anëtarët e komisionit të ofrojnë propozimet e tyre.

Qerim Bajrami, ai propozoi që në plan të punës, të renditet si pikë e veçantë, ftesa ministrave të linjes për të raportuar lidhur me planet e tyre nga aspekti i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve joshumic.

Sa i përket vizitës së Komisionit në regjion, propozoi të vizitohet: Republika e Kroacisë, Republika a Malit të Zi, Republika e Maqedonisë, Republika e Shqipërisë, në Republikën e Serbisë – Novi Pazar, me qëllim të shohim përvojat e jetesës së komuniteteve në këto rajone.

Si propozimi i tij ishte që këtë vit, GP të vazhdojë procedurat e monitorimit të ligjit për Shërbyes Civil, konkretisht neni 11, Njëherit, kërkoi që të zgjerohet GP me anëtarë tjerë të komisionit, kryesisht pjesë e këtij grupi të jetë edhe kryetarja e komisionit. Ai shtoi se për monitorimin e këtij ligji, nteresim ka paraqit edhe grupi ndërministror, ku do të sjellë rezultate të duhura. Në fund të vitit, Komisioni do të dal me raport final, të cilin do ta procedoj për miratim në Kuvend. Ai potencoi se GP duhet të bëjë nismën për procedimin e monitorimit të Ligji për Vetëqeverisjen Lokale .

Danush Ademi, ishte i mendimit se komisioni nuk ka arritur të shqyrtojë në masë të duhur planin e punës për vitin 2015, për këtë arsye çështjet e pa realizuara duhet të barten për këtë vit.

Sipas programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2016, si propozim i tij ishte që Komisioni të rishikojë disa projektligjeve që janë në interesë të komuniteteve, siq janë: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, të bëher rishikimi periodik i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Projektligji për shfrytëzimin dhe menaxhimin e objekteve sportive, vërejtja është se nuk financohen anëtarët e komuniteteve në disa komuna, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Punës ku do të ftohet ministri për të raportuar sa janë të përfshira komunitetet me këtë ligj.

Gjithashtu, propozoi që të rishikohen Projektligjet që kan të bëjnë me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjeve të Forcës së Armatosurë të Kosovës.

Ishte i mendimit që komisioni të mbajë takime çdo javë, me arsye të mos mbeten të parealizuar pikat sipas planit të punës për vitin 2016

Agim Çeku, ishte i të njëjtit mendim që Komisioni të vizitoi Republikën e Kroacisë, me qëllim të merren përvoja të mira e të cilat janë kontributdhëse për komunitetet. Mirë është të planifikohet vizita në muajin maj apo qershor 2016.

Ai, propozoi që Komisioni të vizitoi edhe Republikën e Malit të Zi, vend me popullat multietike ku përvojat e tilla janë parakusht i procesit për stabilizim të komunitetit joshumicë. Njëherit falenderohet për përkrahjen financiare nga ana e organizatës së OSBE-së

Në kuadër të vizitave në terren, propozoi që Komisioni të vizitojë pjesën veriore të Kosovës, p.sh komunën e Leposaviqit, të ndëgjohen zërat e qytetarëve të komunitetit pakicë shqiptar, si zhvillohet jetesa e tyre në këtë komunë, sa janë të inkuadruar në shoqëri dhe pengesat që ata ballafaqohen. Gjithashtu, të vizitohen fshatrat e komunitetit serb të cilët kanë mbetur jashtë komunave të reja, p.sh Pejë, në Brestovik, Sig, Gorazhdek, në fshatrat e Istogut, të Skenderajit etj. Pasi të përfundohen vizitat në terren, komisioni të thërras ministrin e linjës përkatëse me qëllim që të zotohet të ofroj përkrahje të plotë qytetarëve në këto rajone.

Në aktivitete të Planit të punës duhet të jenë të identifikuara datat e festave të komuniteteve joshumicë.

Milka Vuletic, pajtohet me parafolësit lidhur me vizitën në Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Malit të Zi, përvojat e tyre do jen shembëll i shkëlqyeshëm për integrimin e komuniteteve në shoqërin kosovare.

Sa i përket aktiviteteve në terren, ajo propozoi që të vizitohen fshatrat me mjedis të përzierë p.sh Brisnicë, Kushtovë, Vraçev ku kërkesat e qytetarëve janë të shumta të inkuadrohen në shoqëri. Fëmijët e Vraçevës janë të interesuar të ndjekin aktivitete të ndryshme kulturore, por nuk kanë qendër dhe atyre iu duhet të udhëtojnë në komunën e Leposaviq. Në këtë drejtim, ne si komision duhet të jemi të orientuar të ndëgjojmë kërkesat e qytetarëve, nga se vitet e fundit institucionet qeveritare nuk kanë dhënë përkrahje të duhur, në këto rajone.

Mufera Sinik- theksoi se plani i punës për vitin 2015, ka qen shumë i thukt, mirëpo nuk kemi arritur të realizojmë të gjitha pikat për arsye të situatës së krijuar institucionale. Ishte e mendimit që këtë vit, si komision do të jemi më aktiv në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me Plan të punës. Ajo pajtohet me propozimet ngritura nga kolegët. Por ajo veçoi se çështja e arsimit është e një rëndësie të veçantë, çdo ligj ndikon në mësimin e komuniteteve e veçanërisht Ligji për përdorimin e gjuhëve. Me këtë rast, propozoi të vizitohen shkollat në komuna e Prizrenit- Mamushë, si zhvillohet mësimi në gjuhën turke dhe boshnjake, drejtorja për verifikim të dokumentacioneve.

Sasa Milosavjeviq, theksoi se komisioni me përpikëri ka kryer dhe proceduar të gjitha raportet me rekomandime dhe detyrat tjera të përcaktuara në bazë të agjendës Parlamentare. Ishte i mendimit të njëjt lidhur me realizimin e vizitave regjionale. Mirë është që së pari të planifikohet vizita në Republikën e Kroacisë për muajin maj 2016, ndërsa në Mal të Zi në muajin korrik.

Kur bëhet fjalë për vizitat në terren, është me vend kërkesa që të vizitohen komunat me popullat multietnike dhe etnike. Dha si propozim konkret, që të vizitohet komuna e Shtërpçës, që të shohim për së afërmi si zhvillohet jetesa e komuniteteve, në këtë komunë.

Pajtohet që në plan të punës të veçohet, identifikimi i festave të komunitetit pakicë. Me kënaqësi do të pranoj ftesën për një ditë festive p. sh të komunitetit turk, dhe prersonalisht do të marr pjesë në atë manifestim.

Veton Berisha, për funksionalizimin e ideve dhe programeve që u diskutuan sot, si propozim i tij ishte që me iniciativë të kryesueses së komisionit dhe në bashkëpunim me administratën të caktohen agjenda javore. Me këtë rast do të krijohet kushtet në rrealizimin e të gjitha çështjeve të përcaktuara me plan të punës, për vitin 2016. Ishte i mendimit që komisioni të planifikojë vizita në terren, takime me institucione qendrore dhe lokale, në raste të veçanta të ftohen ministrat e linjave përkatëse, me arsye të marrjes së informacioneve për rezultatet e arritura dhe ngecjet eventuale.

Është ide e mirë që në takimet e komisioni të ftoj ministri i FSK-së dhe ministri i Punëve të Brendshme për të raportuar lidhur me përbërjen e komunitetit multietnik, kyqja e policëve të komuniteteve në këto institucione, çështje me rëndësi për arritjen më efektive në tërë territorin e Kosovës.

Në agjendën e programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2016, nuk është paraparë Projektligji për festat zyrtare dhe se i njëjti nuk është votuar as në vitin e kaluar, në Kuvend. Ekziston arsya se duhet të shtohet një ditë e festave nacionale për komunitetin egjimtian, kroat dhe malazez.

Në hartimin e Planit të punës për vitin 2016, dha propozim konkret që në muajin shkurt të planifikohet vizitë zyrtare me ministrin e MASHT-it, lidhur me regjistrimin e sutdentëve të komunitetit joshumicë, për vitin akademik 2015/2016.

Agim Kikaj, theksoi se për hartimin e Planit të punës për vitin 2016, për bazë duhet të merret agjenda e programit të vitit paraprak. Mendon se këtë vitë, komisionit duhet të jetë më konstruktiv dhe më përgjegjës në kryejen e detyrave me tematikë që është shqetësuese dhe reale për komunitetin joshumicë. E gjithë kjo është në të mire të Komisionit sepse në mënyrë racionale do të kryhen objektivat në realizimin e qëllimeve programore.

Gjithashtu, pajtohet me propozimin e parafolësve për aktivitetet e përcaktuara të grupeve punues lidhur me monitorimin e ligjeve, realizimin e vizitave në terren dhe vizitave regjionale.

Kryesuesja, tha se dakordohet që komisoni të mbajë takime të rregullta çdo javë, me qëllim të realizimit të planit të punës për vitin 2016.

I njoftoi anëtarët e komisionit se në Planin e punës së Komisionit, për vitin 2016, do të përfshihet mbikqyrja buxhetore e shpenzimeve për ministrinë e linjes. Gjithashtu, të përfshihen edhe shqyrtimi i raporteve periodike të shpenzimeve (tre mujore dhe nëntëmujore).

Në bazë të diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Në kuadër të hartimit të Draft-Planit të punës së Komisionit për vitin 2016, do të organizohet puntoria në bashkëpunim me administratën dhe misionin e OSBE-së, me datën 5.02.2016, në ora 10:00-12:00 në Hotel ‘ Sirius’

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Jasmina Zhivković